



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:144920  
Datë: 24.10.2022  
Numri i dokumentit: 03562884

C.nr.1008/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala dhe bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Halilaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëseve D.M, L.T, M.L, R.M dhe A.P, që të gjitha nga Gjakova, të cilët me autorizim i përfaqëson i autorizuari Fitim Gashi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-DKA, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 14,487.75.-€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të autorizuarit të të paditurës, me datë 10 tetor 2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëseve D.M, L.T, M.L, R.M dhe A.P dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - DKA, që :

- ◇ Paditëses D.M nga Gjakova të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2,437.85.-€ (dymijë e katërqind e tridhjetë e shtatë euro e tetëdhjetë e pesë cent) dhe atë:
  - në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 24.06.2022, respektivisht për 361 ditë të pranisë në punë, shumën prej 722.00.-€,
  - në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 31 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 05.07.2018 deri me datë 31.01.2021 (për çdo muaj shumën nga 55.35 euro) shumën prej 1,715.85.-€
- ◇ Paditëses L.T nga Gjakova të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2,293.85.-€ (dymijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre euro e tetëdhjetë e pesë cent) dhe atë:
  - në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 24.06.2022, respektivisht për 289 ditë të pranisë në punë, shumën prej 578.00.-€,
  - në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 31 muaj të licencimit dhe atë për

periudhën kohore nga data 05.07.2018 deri me datë 31.01.2021 (për çdo muaj shumën nga 55.35 euro) shumën prej 1,715.85.-€

- ◇ Padi tëses M.L nga Gjakova të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,917.45.-€ (njëmijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë euro e dyzet e pesë cent) dhe atë:
  - në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 24.06.2022, respektivisht për 355 ditë të pranisë në punë, shumën prej 710.00.-€,
  - në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 19% të pagës bazë për 31 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 05.07.2018 deri me datë 31.01.2021 (për çdo muaj shumën nga 38.95 euro) shumën prej 1,207.45.-€
  
- ◇ Padi tëses R.M nga Gjakova të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,785.45.-€ (njëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë euro e dyzet e pesë cent) dhe atë:
  - në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 24.06.2022, respektivisht për 337 ditë të pranisë në punë, shumën prej 578.00.-€,
  - në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 19% të pagës bazë për 31 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 05.07.2018 deri me datë 31.01.2021 (për çdo muaj shumën nga 38.95 euro) shumën prej 1,207.45.-€
  
- ◇ Padi tëses A.P nga Gjakova të ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2,429.85.-€ (dymijë e katërqind e njëzet e nëntë euro e tetëdhjetë e pesë cent) dhe atë:
  - në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 31.08.2021, respektivisht për 357 ditë të pranisë në punë, shumën prej 714.00.-€,
  - në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 31 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 05.07.2018 deri me datë 31.01.2021 (për çdo muaj shumën nga 55.35 euro) shumën prej 1,715.85.-€

Të gjitha shumat e lartcekura, detyrohet e paditura që të i paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit për secilin paditës, e cila do të llogaritet nga data 05.07.2021 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 2,970.40.-€ (dymijë e nëntëqind e shtatëdhjetë euro e dyzet cent), të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëseve mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për

paditësen D.M shumën prej 774.90 euro, për paditësen M.L shumën prej 545.30 euro, për paditësen R.M shumën prej 545.30 euro, për paditësen A.P shumën prej 779.90 euro, ndërsa për paditësen L.T, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit shumën prej 208 euro si dhe në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit 774.90 euro.

### A r s y e t i m

Paditëset D.M, L.T, M.L, R.M dhe A.P, që të gjitha nga Gjakova përmes të autorizuarit të tyre Fitim Gashi, avokat në Prishtinë dhe Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, në këtë gjykatë me datë 05.07.2021, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditëset janë punëtore të arsimit në SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë. Meqenëse e paditura nuk iu ka paguar të njëjtëve shujtën për ushqim ditor, e as kompensimin për kualifikim të zhvillimit profesional, atëherë të njëjtit kanë paraqitur padi me të cilat kanë kërkuar shumat përkatëse, kanë kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale. I autorizuari i paditësve me parashtrësën e datës 05.09.2022, ka bërë precizimin e kërkesëpadsisë në aspektin objektiv për të gjithë paditësit, dhe atë: D.M për 361 ditë punë të realizuara në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit shumën prej 722,00 euro, ndërsa në emër të kualifikimit për 45 muaj nga data 18.04.2017-31.01.2021 27% të vlerës te pagës bazë, në shumën prej 2,490.75-€; L.T, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit shumën prej 786,00 euro për 393 ditë punë ( periudha 19.09.2020-23.04.2021 104 dite dhe 14.09.2021-24.06.2022, 289 ditë), ndërsa në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 45 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 18.04.2017-31.01.2021, shumën 2,409.75 euro, M. L. në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 24.06.2022, respektivisht për 355 ditë të pranisë në punë, shumën prej 710.00.-€, dhe në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 19% të pagës bazë shumën prej 1,752.75 euro, periudhën kohore nga data 18.04.2017-31.01.2021, R.M në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 24.06.2022, respektivisht për 337 ditë të pranisë në punë, shumën prej 710,00.-€, në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 19% të pagës bazë shumën prej 1,752.75euro, për periudhën kohore nga data 18.04.2017- 31.01.2021 dhe për paditësen A.P, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga 14.09.2020 e deri me datë 31.08.2021, respektivisht për 357 ditë të pranisë në punë, shumën prej 714,00.-€, në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 45 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 18.04.2017-31.01.2021 shumën prej 2,490.75 euro, e të gjitha këto për të gjithë paditësit me kamatën ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri ne pagesën definitive, nën kërcënim te përmbarimit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor i autorizuari i paditësve ka deklaruar se: mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj si dhe precizimit të datës 05.09.2022. Sa i përket përgjigjes në padi dhe përfundimit të të paditurës se kërkesat e paditësve janë parashkruar, konsideroi se një

pretendim i tillë është i pa bazuar, pasi që kërkesat për pagesën mbi bazën e kualifikimit arsimor, edhe për kundër faktit që kërkesën nga data 18.04.2017 dhe padia është dorëzuar me datë 05.07.2021, nuk mund të konsiderohet e parashkruar nga fakti se e paditura në mënyrë periodike për çdo muaj ja ka paguar një pjesë të këtij kompensimi siç mund të shihet edhe nga lista e pagës për secilin paditës e cila provë është në shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë e saj kjo pagesë e ndërprerë parashkrimin e kërkesë së paditësve për pagesë mbi bazën e kualifikimit arsimor. Ndërkaq sa i përket kërkesës për shujta kërkesat e paditësve janë nga data 14.09.2020 e tutje, që do të thotë nuk kemi të bëjmë fare me parashkrim. Gjersa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se u vërtetua kërkesëpafia si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia e saj, andaj i propozoi kësaj Gjykate që të nxjerrë Aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesë padinë e paditësve në shumat e precizuara sipas parashtrësës së datës 06.09.2022, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga data e dorëzimit të padisë e deri në pagesën definitive.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë: për padi shumën prej 624.00.-€, për taksë shumën prej 20.00.-€, për parashtrësën e datës 05.09.2022 shumën prej 624.00.-€, për dy seanca të mbajtura nga 811.20.-€ x 2=1,622.40.-€, e që në total arrin shumën prej 2,890.40.-€.

Gjyqtarja e çështjes në seancën e datës 10.10.2022 ka detyruar të autorizuarin e paditësve që në afat prej 3 ditësh të bëjë pagesën e diferencës së taksës dhe atë në vlerë prej 80.00 euro, nën kërcënim të pasojave ligjore, ashtu që i autorizuari i paditësve me parashtrësën e datës 10.10.2022 ka njoftuar gjykatën se e ka paguar diferencën në emër të taksës gjyqësore në vlerë prej 80.00 euro, ku ia ka bashkangjitur edhe Urdhërpagesën në emër të diferencës së taksës gjyqësore për lëndën C.nr.1008/21, andaj ka kërkuar që si shpenzim i procedurës të i paguhet edhe kjo shumë.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarit të saj D. B., në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 22.06.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që MASHT-i dhe SBASHK-u, nuk janë të angazhuar për t'i informuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit etj. Po ashtu i njëjti është thirrur në parashkrim konform nenit 87 të Ligjit të Punës, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditësës ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata në kuptim të nenit 423 par.4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt. Po ashtu gjykata të paditurës së bashku me thirrjen për seance i ka proceduar edhe ndryshimin e padisë se bashku me provat e paraqitur nga i autorizuari i paditësve por që e njëjta nuk është deklaruar në lidhje me të.

Pas kësaj gjykata e ka lejuar ndryshimin e padisë-zmadhimin e kërkesës së paditësve në aspektin objektiv.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor-publik ka administruar provat si në vijim : Kontrata e punës për paditësen D.M e lëshuar

nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 11/17, Diploma – Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, në versionin e fotokopjuar, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Selman Riza" në Gjakovë, me numër të protokollit 541/22 e datës 23.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit për paditësen D.M, Licenca e mësimdhënësit me numër 100008508, Kopja e letërnjoftimit për paditësen D.M, Kontrata e punës për paditësen L.T e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 32/18, Diploma – Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, në versionin e fotokopjuar, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Selman Riza" në Gjakovë, me numër të protokollit 539/22 i datës 23.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit për paditësen L.T, Licenca e mësimdhënësit me numër të protokollit 1027423, Kopja e letërnjoftimit për paditësen L.T, Kontrata e punës për paditësen M.L të lëshuara nga Komuna e Gjakovë – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 25/15, Diploma – Universiteti i Prishtinës, SHLP "Bajram Curri" në Gjakovë, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Selman Riza" në Gjakovë, me numër të protokollit 550/22 i datës 30.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit për paditësen M.L, Licenca e mësimdhënësit me numër 100008913, Kopja e letërnjoftimit për paditësen M.L, Kontrata e punës për paditësen R.M të lëshuar nga Komuna e Gjakovë – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 27/15, Diploma – Universiteti i "Kiril dhe Metodij" në Shkup, versionin e fotokopjuar, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Selman Riza" në Gjakovë, me numër të protokollit 536/22 e datës 23.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit për paditësen R.M, Licenca e mësimdhënësit për paditësen R.M me numër 100008939, Kopja e letërnjoftimit për paditësen R.M, Kontrata e punës për paditësen A.P të lëshuar nga Komuna e Gjakovë – DKA, në versionin e fotokopjuar, numër 41/15, Diploma – Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Gjakovë, në versionin e fotokopjuar e vërtetuar, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Selman Riza" në Gjakovë, me numër të protokollit 538/22 i datës 23.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit për paditësen A.P, Licenca e mësimdhënësit me numër 100021342, Kopja e letërnjoftimit për paditësen A.P, Lista e pagës për të gjithë paditëset,

Gjykata pas analizimit të fakteve juridike relevante të kësaj çështjeje, vlerësimi veç e veç të provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetoi se kërkesëpadia e paditëseve është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

#### *Për paditësen D.M*

Nga Kontrata e punës për paditësen e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 11/17, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi i lartcekur është në marrëdhënie pune te e paditura Komuna e Gjakovës–DKA, respektivisht në shkollën "Selman Riza" në Gjakovë, si mësimdhënëse e mësimi klasor.

Nga Diploma – Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, në versionin e fotokopjuar, gjykata ka vërtetuar se paditësja me datë 18.07.2009 ka përfunduar studimet në universitetin e lartcekur dhe është kualifikuar Baçelor i programit fillor. Licenca e mësimdhënësit me numër 100008508, gjykatës i ka vërtetuar faktin se paditësja ka licencë të rregullt dhe të karrierës, e lëshuar me datë 26.12.2012 dhe me datë të skadimit 26.12.2017

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Selman Riza" në Gjakovë, me numër të protokollit 541/22 e datës 23.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit, gjykata ka vërtetuar se për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datën 24.06.2022 paditësja e lartcekur ka realizuar 361 ditë pune. Nga Kopja e letërnjoftimit për paditësen D.M, gjykata ka vërtetuar identitetin e saj.

*Për paditësen L.T*

Nga Kontrata e punës e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 32/18, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune te e paditura Komuna e Gjakovës–DKA, respektivisht në shkollën "Selman Riza" në Gjakovë, si mësimdhënëse e Kimisë.

Nga Diploma – Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, në versionin e fotokopjuar, gjykata ka vërtetuar se paditësja me datë 02.07.2007 ka përfunduar studimet në universitetin e lartcekur dhe ka marrë kualifikimin profesor i biologjisë-kimisë. Licenca e mësimdhënësit me numër të protokollit 1027423, gjykatës i ka vërtetuar faktin se paditësja ka licencë të rregullt dhe të karrierës, e lëshuar me datë 01.10.2019 dhe me datë të skadimit 01.10.2024. Nga Kopja e letërnjoftimit për paditësen L.T, gjykata ka vërtetuar identitetin e saj

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Selman Riza" në Gjakovë, me numër të protokollit 539/22 i datës 23.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit, gjykata ka vërtetuar se për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datën 24.06.2022 paditësja e lartcekur ka realizuar 289 ditë pune..

*Për paditësen M.L*

Nga Kontrata e punës të lëshuara nga Komuna e Gjakovë – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 25/15, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune te e paditura Komuna e Gjakovës–DKA, respektivisht në shkollën "Selman Riza" në Gjakovë, si mësimdhënëse e Matematikës.

Nga Diploma – Universiteti i Prishtinës, SHLP "Bajram Curri" në Gjakovë, gjykata ka vërtetuar se paditësja me datë 18.11.1988 ka përfunduar studimet në shkollën e lartë pedagogjike të lartcekur dhe ka marrë titullin profesional arsimtare e matematikës. Licenca e mësimdhënësit me numër 100008913, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka licencë të rregullt dhe të karrierës, e lëshuar me datë 26.12.2012 dhe me datë të skadimit 26.12.2017

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Selman Riza" në Gjakovë, me numër të protokollit 550/22 i datës 30.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit për paditësen, gjykata ka vërtetuar se për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datën 24.06.2022 paditësja e lartcekur ka realizuar 355 ditë pune. Nga Kopja e letërnjoftimit për paditësen, gjykata ka vërtetuar identitetin e saj.

*Për paditësen R.M*

Nga Kontrata e punës të lëshuar nga Komuna e Gjakovë – DKA, në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 27/15, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune te e paditura Komuna e Gjakovës–DKA, respektivisht në shkollën “Selman Riza” në Gjakovë, si mësimdhënëse e mësimit klasor.

Nga Diploma – Universiteti i “Kiril dhe Metodij” në Shkup, versionin e fotokopjuar, gjykata ka vërtetuar se paditësja me datë 24.09.1981 ka përfunduar studimet në universitetin e lartcekur dhe ka marrë titullin profesional mësues i mësimdhënies në gjuhën shqipe. Licenca e mësimdhënësit për paditësen me numër 100008939, gjykatës i ka vërtetuar faktin se paditësja e lartcekur ka licencë të rregullt dhe të karrierës, e lëshuar me datë 26.12.2012 dhe me datë të skadimit 26.12.2017.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 536/22 e datës 23.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit për paditësen, gjykata ka vërtetuar se për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datën 24.06.2022 paditësja e lartcekur ka realizuar 337 ditë pune. Nga Kopja e letërnjoftimit për paditësen, gjykata ka vërtetuar identitetin e saj.

#### *Për paditësen A.P*

Nga Kontrata e punës të lëshuar nga Komuna e Gjakovë – DKA, në versionin e fotokopjuar, numër 41/15, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune te e paditura Komuna e Gjakovës–DKA, respektivisht në shkollën “Selman Riza” në Gjakovë, si mësimdhënëse e mësimit klasor.

Nga Diploma – Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit në Gjakovë, në versionin e fotokopjuar e vërtetuar, gjykata ka vërtetuar se paditësja me datë 24.02.2009 ka përfunduar studimet në universitetin e lartcekur dhe ka marrë titullin Bachelor i programit fillor. Licenca e mësimdhënësit me numër 100021342, gjykatës i ka vërtetuar faktin se paditësja A.P ka licencë të rregullt dhe të karrierës, e lëshuar me datë 18.07.2014 dhe me datë të skadimit 18.07.2019.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 538/22 i datës 23.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit për paditësen A.P, gjykata ka vërtetuar se për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datën 24.06.2022 paditësja e lartcekur ka realizuar 357 ditë pune.

Nga Lista e pagës për të gjithë paditëset, gjykata ka vërtetuar faktin se paga bazë e paditëseve D.M, L.T, M.L, R.M dhe A.P është 421.00 euro.

*Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës sa i përket kompensimit lidhur me shpenzimet e ushqimit*

Me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës 01/B e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021,

në mënyrë identike parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.* Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditëset janë të punësuar te e paditura, përkatësisht në shkollën “Selman Riza” në Gjakovë, ashtu që për periudhën 14.09.2020-24.06.2022, paditësja D.M ka realizuar gjithsej 361 ditë punë, paditësja L.T ka realizuar gjithsej 289 ditë punë, paditësja M.L ka realizuar gjithsej 355 ditë punë, paditësja R.M ka realizuar gjithsej 337 ditë punë dhe paditësja A.P ka realizuar gjithsej 357 ditë pune. Të gjitha këto vërtetohen nga vërtetimet e lartcekura të lëshuara nga shkolla “Selman Riza” në Gjakovë. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëseve nuk iu ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me dispozita ligjore të lartcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëseve sa i përket sa i përket shpenzimeve të ushqimit është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përllogaritjen në atë mënyrë që e ditët e kaluara në punë të paditëseve i ka shumëzuar me 2, andaj edhe iu njohi paditëseve shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

*Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës sa i përket kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit*

Me nenin 7 par.1 nën par. 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, parashihet që *“me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.2. Mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike dy vjeçare 19% të pagës bazë”, 1.3. Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë”.* Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditëset D.M, L.T dhe A.P kanë diplomë fakulteti, ndërsa paditësen M.L dhe R.M kanë diplomë të shkollës së lartë pedagogjike, rrethana këto të vërtetuara nga Diplomat përkatëse të lartcekura. Po ashtu, të gjithë paditëset kanë licenca të rregullta dhe lloj të licenës të karrierës. Ndërsa nga lista e pagave për secilën paditëse, gjykata ka vërtetuar se të njëjtat realizojnë pagë bazë në vlerë prej 421 euro, si dhe gjykata ka vërtetuar faktin se paditëseve për çdo muaj iu është paguar një shumë e caktuar në emër të kualifikimit, ashtu që paditëseve D.M, L.T dhe A.P iu është paguar shuma prej nga 58.32 euro, ndërsa paditëseve M.L dhe R.M iu është paguar shuma prej nga 41.04 euro. Në përputhje me nenin 7 pika 1.2 dhe 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, paditëseve D.M, L.T dhe A.P iu takon e drejta e kompensimit në lartësi prej 27% të pagës bazë, ndërsa paditëseve M.L dhe R.M iu takon e drejta e kompensimit në lartësi prej 19 % të pagës bazë. Në rastin konkret gjykata vendosi duke përllogaritur në atë mënyrë që për secilën paditëse, 31 muaj të punës i ka shumëzuar me shumën e mbetur nga shtesa lidhur me kualifikimin, duke iu njohur shumat si në pikën I dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Po ashtu, duhet theksuar se me Udhëzimin Administrativ 5/2017, Sistemi i Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë, në nenin 33 par.1 nën par.1.1. përcaktohet që vazhdohet për pesë vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014, në rastin konkret licenca e paditëseve D.M, M.L, R.M iu skadon me datë 26.12.2022, ndërsa paditëses A.P me datë 18.07.2024.



Gjykata vë në dukje që në rastin konkret ka gjetur se paditësja R.M në bazë të Vërtetimit të lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 536/22 e datës 23.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit, e njëjta ka realizuar gjithsej 337 ditë pune, andaj të njëjtës i takon kompensimi në emër të ushqimit në vlerë prej 674.00 euro, mirëpo gjykata ia njohi vetëm shumën prej 578.00 euro, siç është precizuar në parashtresën e të autorizuarit të saj të datës 05.09.2022, edhe pse ka vërtetuar që në rastin konkret paditëses i takon shuma më e lartë se ajo që e ka aprovuar, mirëpo nuk mundi të vendosë ndryshe duke pasur parasysh dispozitën e nenit 2 par.1 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*, andaj vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes për të gjitha kërkesat ka marrë parasysh edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret, nga gjendja faktike e vërtetuar sipas kontratave të punës për paditësit, gjykatës i rezultoi se e paditura është punëdhënëse e paditëseve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorëve, përkatësisht këtu paditëseve në rastin konkret, të iu paguajë vlerën e kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pretendimet e të paditurës se nuk ka planifikim buxhetor për këto kompensime, i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësit në rrugë gjyqësore kanë filluar ta realizojnë një të drejtë ligjore që iu garanton Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe ajo e vitit 2021 kurse mungesa e buxhetit të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosje ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pjesës refuzuese si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e refuzoi kërkesën e paditëseve për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri me datë 04.07.2021, pasi që pretendimet e të autorizuarit të të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjykata i morri si të bazuara pasi që sipas provave të administruara vërtetohet se paditësi kërkesën e tij për kompensimin në emër të kualifikimit e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj në rastin konkret padia për këtë periudhë kohore është parashtruar me datë 05.07.2021 që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për çka gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimeve të të autorizuarit të paditëseve se në rastin konkret nuk kemi parashkrim të kërkesës pasi që kërkesat për pagesën mbi bazën e kualifikimit arsimor nuk mund të konsiderohet e parashkruar nga fakti se e paditura në mënyrë periodike për çdo muaj ja ka paguar një pjesë të këtij kompensimi siç mund të shihet edhe nga lista e pagës për secilin paditës e cila provë është në shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë e saj kjo pagesë e ndërprerë parashkrimin e kërkesës së paditësve për pagesë mbi bazën e kualifikimit arsimor, por gjykata e gjeti këtë pretendim si të pabazuar, pasi që duke pasur parasysh dispozitën e nenit 342 par.1 të LMD-së, sipas të cilit *“Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër.”*, ashtu që në rastin konkret e paditura nuk e ka përmbushur në tërësi obligimin e saj sa i përket kompensimit mbi bazën e kualifikimit, dhe për pjesën tjetër që nuk e ka përmbushur paditësit kanë pasur të drejtë që të kërkojnë përmbushjen e detyrimit brenda afatit prej tre viteve nga momenti që iu ka lindur e drejta për të kërkuar përmbushjen e saj, pra nga dita kur e paditura ka pasur për detyrë që të bëjë këtë pagesë, andaj meqenëse padia është paraqitur me datë 05.07.2021 ndërsa periudha kohore për të cilën kërkohet kompensimi mbi bazën e kualifikimit është nga data 18.04.2017 deri më datë 31.01.2021, gjykata erdhi në përfundim se periudha prej datës 18.04.2017 deri me datë 04.07.2018 është parashkruar për arsyet e elaboruara më lartë.

Gjykata po ashtu refuzoi edhe kërkesën për shpenzimet e ushqimit për paditësen L.T në shumë prej 208.00 euro për periudhën 14.09.2020-23.04.2021, pasi që sipas Vërtetimit të lëshuar nga SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, me numër të protokollit 539/22 i datës 23.08.2022 lidhur me shpenzimet e ushqimit për paditësen L.T, gjykata ka vërtetuar se në periudhën prej datës 14.09.2020 deri me datë 24.06.2022 e njëjta ka realizuar gjithsej 289 ditë pune dhe periudha për të cilën paditësja ka kërkuar që të i njihen shpenzimet e ushqimit përfshihet në periudhën të cilën gjykata ia ka njohur, andaj edhe e refuzoi pjesën tjetër të saj.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën I të dispozitivit, u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç‘rast paditësve iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 2,970.40.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 100.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 624.00.-€, për

përfaqësimin e të autorizuarit të paditësve në dy seanca shumë prej nga 811.20.-€, apo për të dy seancat shumë e përgjithshme prej 1,622.40.-€ të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 7), si dhe për parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 624.00.-€.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.1008/21, datë 10 tetor 2022

Gj y q t a r j a,  
Mirjeta Shala

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita vijuese pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.